



INTERNATIONAL WOMEN'S SUMMIT SAMITI NDËRKOMBËTAR I GRUAS MEËUNARODNI SAMIT ŽENA



OCTOBER 4-6, 2012
PRISTINA, KOSOVO

4-6 TETOR 2012
PRISHTINË, KOSOVË

4-6 OKTOBRA 2012
PRIŠTINA, KOSOVO



PARTNERITETI PËR NDRYSHIM

FUQIZIMI I GRUAS

**Prishtinë, Kosovë
4 deri 6 tetor 2012**

PARIMET E PRISHTINËS

Ne, pjesëmarrësit në samitin ndërkombëtar 'Partneriteti për ndryshim – fuqizimi i gruas,' organizuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, duke përfaqësuar sektorë, shtete, etni, mosha, kultura dhe tradita të shumëllojshme, jemi mbledhur në Prishtinë për të diskutuar për strategjitë dhe praktikën më të mira për avancimin e sigurisë dhe drejtësisë, fuqizimin ekonomik dhe përfaqësimin politik të gruas. Duke reflektuar aspiratat e grave nga shtetet tona përkatëse dhe në solidaritet me gratë në mbarë botën, sidomos ato që aktualisht gjenden në zona konflikti, i ritheksojmë parimet dhe rekomandimet e mëposhtme:

--Duke pasur parasysh Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (1948); Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950); Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) (1979); Deklaratën e OKB-së për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas (1993); Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim (1995); Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (2000) dhe Rezolutat përkatëse 1820 (2008), 1888 (2009), 1889 (2009) dhe 1960 (2010); Rishikimin e zbatimit të Platformës për Veprim, Pekini Plus 15 (2010); si dhe konventat tjera ndërkombëtare për mbrojtjen humanitare të civilëve dhe të refugjatëve, për të drejtën penale si dhe kundër korrupsionit;

--Duke ritheksuar barazinë themelore të grave dhe burrave në të gjitha angazhimet njerëzore dhe të drejtat e patjetërsueshme të të gjitha grave në jetë, liri dhe siguri personale;

--Duke i theksuar zotimet tona të plota dhe të përbashkëta, meqë gratë përbëjnë më shumë se 50 për qind të popullatës së botës dhe kanë përvoja të veçanta dhe të shumëllojshme, si lidere për të fuqizuar të gjitha gratë në fushën ekonomike, politike dhe sociale si anëtare aktive të shoqërisë;

--Duke përfituar nga përvojat në rajon, por të cilat janë të ndërlidhura me demokracinë në zhvillim dhe partnerët që punojnë në këto fusha; dhe

--Të bindur që udhëheqësia e grave në institucione qeveritare, politike dhe shoqërisë civile sjell të mira në familje, shoqëri dhe shton paqen dhe sigurinë globale;

Ne ritheksojmë që:

- Pengesat e të gjitha llojeve – politike, sociale, zgjedhore, ekonomike, ligjore dhe kulturore – në pjesëmarrjen e plotë të gruas në shoqëri duhet të hiqen, në mënyrë që të sigurohen të drejtat e patjetërsueshme të gruas;
- Mundësitë e të gjitha llojeve – ekonomike, politike sociale dhe kulturore – duhen rritur dhe mbështetur, ashtu që gratë të mund të realizojnë aspiratat e tyre individuale, dhe së bashku me burrat të arrijnë

barazinë gjinore. Qasja e plotë dhe e barabartë e vajzave dhe femrave të reja në arsim është parakusht për të gjitha mundësitë tjera;

- Fuqizimi ekonomik i gruas çon në rritje të përgjithshme ekonomike dhe qasje universale në siguri, drejtësi, resurse, duke përfshirë pronat, si dhe vendimmarrje qeveritare;
- Fuqizimi ekonomik i gruas buron nga dhuntitë dhe shkathtësitë e gruas, dhe merr formë kur gratë të kenë mundësi të barabarta, duke përfshirë të drejtat e tyre të plota ligjore dhe qasjen e drejtë në mundësi dhe resurse;
- Qasja dhe pjesëmarrja e vazhdueshme në proceset e sigurisë dhe drejtësisë janë jetike. Gratë nuk mund të avancohen në kuptimin ekonomik, social apo politik nëse nuk trajtohen keqtrajtimet e mëhershme, nëse mohohen të drejtat e tyre të njeriut, komprometohet siguria e tyre dhe humbin dinjitetin e tyre;
- Gratë duhet të kenë role udhëheqëse në procese të ruajtjes së paqes dhe të negocimit/zgjidhjes së konflikteve, si dhe në zgjidhjet politike pas konfliktit, rindërtimin ekonomik, rehabilitimin social dhe zhvillimin demokratik. Nevojat e posaçme të grave që jetojnë në zona të konfliktit/pas konfliktit duhet të pranohen dhe të marrin përgjigjen me veprime të fuqishme dhe të qëndrueshme qeveritare;
- Korrupsioni minon në mënyrë joproportionale fuqizimin e gruas, duke penguar qasjen e saj në resurse ekonomike, drejtësi dhe siguri, pjesëmarrje politike dhe vendimmarrje qeveritare. Leadershipi i gruas në nismat kundër korrupsionit është vendimtar për të krijuar dhe mbajtur gjallë besimin publik se korrupsioni mund të luftohet përmes veprimeve të forta dhe të duhura;
- Përfaqësimi i ulët politik i gruas cenon të kuptuarit e shoqërisë të problemeve ekonomike, problemeve të sigurisë, drejtësisë dhe problemeve sociale me të cilat përballet, por edhe gatishmërinë e qeverisë për t'i trajtuar ato në të vërtetë. Për t'i orientuar politikën qeveritare dhe resurset ekonomike në mënyrë që të përmirësohet shoqëria në përgjithësi, është e domosdoshme që më shumë gra të marrin pjesë në jetën publike; dhe
- Harmonizimi gjinor i legjislatimit, buxheteve dhe politikave janë vegla me rëndësi kritike për monitorimin e politikave dhe programeve dhe për të garantuar mundësi e përfitime të barabarta për gra e burra.

Në përputhje me këtë, ne rekomandojmë një sërë veprimesh:

Për t'u ndërmarrë masa në të gjithë sektorët:

- Mbrojtja e qartë e dispozitave kushtetuese, zbatimi i rreptë i ligjit për barazi gjinore dhe ligjeve tjera përkatëse, si dhe zbatimi i plotë i planeve shtetërore të veprimit që realizojnë zotimet e shtetit ndaj konventave ndërkombëtare duke përdorur ndëshkimet dhe masat stimuluese për përmbushjen e tyre;
- Bashkëpunim dhe bashkëveprim për të kërkuar përfshirje të gruas me angazhim të shoqërisë civile, zyrtarëve qeveritarë, partive politike, si dhe mediave, biznesit dhe komuniteteve fetare;
- Krijimi i rrjeteve lokale, rajonale e shtetërore të grave dhe për gratë, siç janë shoqatat e sektorit të sigurisë, grupet ndërpartiake të grave deputete, si dhe shoqatat afariste që i mundësojnë grave të përkrahin gra të tjera, si dhe të udhëzojnë gjeneratën e ardhme të udhëheqësve;
- Angazhim më i madh i burrave si aleatë dhe partnerë;
- Zbatim i proceseve transparente, të cilat mundësojnë përfshirje të gjerë të grupeve më pak të përfaqësuara për shkak të moshës, etnisë, gjeografisë, fesë, orientimit seksual, statusit social dhe aftësive të kufizuara;
- Përpjekje për të rritur dukshmërinë e grave lidere në të gjithë sektorët, përfshirë qeverisjen lokale, rajonale dhe shtetërore, sigurinë dhe sektorin privat me qëllim të ndryshimit të perceptimeve dhe normave; dhe
- Përdorimi i teknologjisë siç janë mediat sociale për të përshpejtuar ndryshimet e kërkuara në këtë dokument.

Arritja e fuqizimit ekonomik të gruas

- Të përkrahen dhe përforcohen aftësitë ndërmarrëse të gruas përmes zhvillimit të shkathtësive, shoqatave të lidërshiptit, qasjes më të madhe në shkollim të lartë, politika fiskale, bankare dhe infrastrukturore të cilat mundësojnë që gratë, madje edhe pa hipotekë apo kursime, të fillojnë apo zgjerojnë biznese;
- T'i mundësohet grave të konkurrojnë në treg, duke zbatuar prokurim publik, politika të punës dhe politika sociale, si dhe buxhete të cilat krijojnë rregulla të barabarta për të gjithë;
- Të inkurajohet larmia gjinore në sektorin privat në kuptim të udhëheqësisë së përgjithshme, menaxhmentit dhe fuqisë punëtore, për shembull përmes përligjjes së kuotave gjinore, si dhe mjediset e korporatave të cilat sigurojnë vendin e gruas në vend të punës;
- Të sigurohet se të drejtat pronësore realizohen me ligj dhe/apo përmes zbatimit të ligjeve duke sanksionuar kërkesat legjitime të grave, përfshirë ato që kanë të bëjnë me pronësi të përbashkët, trashëgimi si dhe zotërim prone;
- T'i mundësohet grave në administratën publike dhe parti politike që të formësojnë dhe udhëheqin politikën, iniciativat e mekanizmat anti-korrupsion; si dhe
- Krijimi i shërbimeve, siç janë kujdesi ditor për fëmijë dhe të moshuar, në mënyrë që gruaja të mund të punojë dhe që të gjithë anëtarët e familjes të jetojnë me mundësi të barabarta dhe të prosperojnë.

Të ngrihet siguria e gruas dhe të zgjerohet qasja e saj në drejtësi

- Të kuptohet që siguria duhet parë në një kuptim më të gjerë, në përputhje me perceptimet e gruas dhe parimet e sigurisë njerëzore, duke integruar konfliktet, papunësinë, katastrofat mjedisore, migrimin, kolapsin financiar dhe ekonomik;
- Të shtohet prania e grave në pozita udhëheqëse në operacione paqeruajtëse, negocime formale, organet për marrëveshje paqësore, si dhe institucione qeverisëse pas konfliktit. Të zhvillohen qasje të qëndrueshme institucionale për komunikim dhe reagim efektiv me gratë në mjedise të konfliktit dhe pas konfliktit;
- Të reformohen institucionet e sektorit të sigurisë për të përmirësuar ndjeshmërinë gjinore në radhët e tyre, duke rritur numrin e grave në pozita udhëheqëse, mbajtur trajnime për diversitetin dhe ndryshuar strukturat organizative për të përmirësuar reagimin ndaj nevojave të qytetarëve për siguri;
- Të parandalohet, të ndiqet penalisht dhe të ndëshkohet dhuna ndaj gruas duke i dhënë fund pandëshkueshmërisë për personat që kanë kryer krime dhe duke kërkuar llogari për zbatim të pamjaftueshëm të ligjeve, për shembull, përmes planeve për matjen e performancës që përcjellin arrestimet dhe ndjekjet penale të krimeve të kryera ndaj gruas, e posaçërisht dhunës në baza gjinore, duke përfshirë këtu edhe trafikimin me qenie njerëzore;
- Të përkrahen nismat për rehabilitim, riintegrim e luftim të stigmatizimit social të viktimave të luftës, trafikimit dhe dhunës seksuale; si dhe
- Të theksohet se proceset dhe institucionet e drejtësisë gjatë konfliktit, pas konfliktit dhe ato tranzicionale duhet të kenë ndjeshmëri gjinore dhe të njohin statusin ligjor të viktimave të përdhunimeve, të njohin publikisht nivelin e përjetimeve të tyre, kompensojë ato për lëndimet e tyre dhe që kryerësit të ndiqen penalisht.

Të rritet pjesëmarrja dhe përfaqësimi politik i gruas

- Të rekrutohen gratë në partitë politike, të përfshihen në lista kandidatësh ku mund të zgjedhen, si dhe të përkrahen gratë në pozita të zgjedhura;
- Të krijohen struktura demokratike brenda partive politike përmes akteve nënligjore, transparencës dhe barazisë së financimit, si dhe procedurave zgjedhore, të cilat iu mundësojnë grave të fitojnë pozita udhëheqëse me pushtet të vërtetë.
- Të ndryshohen ligjet dhe praktikat zgjedhore, të partive dhe fushatave ashtu që të mundësohet përfaqësimi i gruas përmes futjes së dispozitave të kuotave, platformave partiake që i përgjigjen çështjeve të caktuara dhe mënyrës se si kanë ndikim në gratë, edukimit të votuesve që iu ofron grave

zgjedhjet e informuara, si dhe hetimeve të thukta dhe ndjekjes penale të kërcënimeve të paligjshme ndaj votuesve dhe heqjes së të drejtës së votimit;

- Të mbështeten organizatat të cilat realizojnë hulumtime të politikave të ndjeshme nga perspektiva gjinore për të informuar qeverinë, mediat, partitë politike, dhe shoqërinë civile kur marrin vendime për çështjet që ndikojnë në mirëqenien e gruas; si dhe
- Të përdoren masa speciale, siç janë kuotat, për të rritur jo vetëm pjesëmarrjen e gruas por edhe rolin e gruas si vendimmarrëse.